

**VENDIM**  
**Nr. 698, datë 6.12.2023**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES  
TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit "Lista e OKB-së", që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

1. Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohen katër individë të renditur në shkronjën "a", sipas shtesave që i bashkëlidhen këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

2. Në listën e shkronjës "D", të titulluar "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", shtohet kompania e renditur në shkronjën "a", sipas shtesave që i bashkëlidhen këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË  
TERRORIZMIT**  
**SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT**  
**("LISTA E OKB-së")**

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (DA'ESH) DHE AL-QAIDA**

**a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida":**

1. MOHAMED: AMIN; MOSTAFA;
2. SAID JAN: 'ABD AL-SALAM;
3. IYAD: AG GHALI;
4. ABU MOHAMMED: AL-JAWLANI.

**D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA**

**a) Lista e shtuar në "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida"**

1. MAKHTAB AL-KHIDAMAT

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.